



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË ENJTE, 15 NËNTOR 2018, TIRANË

PROCESVERBAL

**SEANCËN E DREJTON
KRYETARI I KUVENDIT
GRAMOZ RUÇI**

(Opozita nuk është e pranishme në këtë seance plenare.)

(Seanca filloi në orën 10:00)

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 06.11.2018 *(neni 44 i Rregullores)*

2. Njoftimi i projektligjeve të depozituara në Kuvend *(neni 44, pika 3, i Rregullores)*

3. Projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 9426, datë 06.10.2005 “Për mbarështimin e blegtorisë”, i ndryshuar” *(nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

Pyetje

Shprehet Komisioni përgjegjës për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin
Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi)

4. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar” *(nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

Pyetje

Shprehet Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Sigurinë Kombëtare.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi)

5. Projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr. 9584, datë 17.07.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura

kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, i ndryshuar” (*nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë*)

Pyetje

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Diskutime

(*Shprehen grupet parlamentare.*)

Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi)

6. Projektligji “Për ratifikimin e Memorandumit të Mirëkuptimit që ndryshon Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e drejtësisë së Bashkimit Europian” (*nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë absolute*)

Pyetje

Shprehet Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Integrimin Europian.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Sigurinë Kombëtare.

Diskutime

(*Shprehen grupet parlamentare.*)

Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi)

7. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP) (*nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë absolute*)

Pyetje

Shprehet Komisioni përgjegjës për Sigurinë Kombëtare.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme.

Diskutime

(*Shprehen grupet parlamentare.*)

Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi)

8. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2017, për projektin “Promovimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes fondit të garancisë së kredive rurale” (*nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë absolute*)

Pyetje

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme.

Diskutime

(*Shprehen grupet parlamentare.*)

Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi)

9. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes me vendin pritës ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor” (*nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë absolute*)

Pyetje

Shprehet Komisioni përgjegjës për Politikën e Jashtme.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Diskutime

(*Shprehen grupet parlamentare.*)

Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi)

10. Të bartura për votim:

- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (*neni 81/2 i Kushtetutës dhe nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë prej 3/5-ve të të gjithë anëtarëve të Kuvendit*)

- Projektligji “Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar” (*neni 81/2 i Kushtetutës dhe nenet 73-77 të*

Rregullores, votim me shumicë prej 3/5-ve të të gjithë anëtarëve të Kuvendit)

11. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (neni 45 i Rregullores)

Koha e diskutimeve deri në 60 minuta

Gramoz Ruçi – Seancën e sotme e deklaroj të hapur.

(Pasi lexon rendin e ditës.)

Njoftoj se vazhdon shqyrtimi në komisione për projektligjet e tjera të parashikuara për sot dhe sipas kalendarit trijavor.

A ka ndonjë vërejtje për dy procesverbalet e seancave të kaluara? Nuk ka.

Miratohe.

Njoftimet në Kuvend: janë depozituar katër projektligje nga Këshilli i Ministrave; nga Presidenti i Republikës është depozituar dekreti për propozimin e zonjës Vitore Tusha si kryetare e Kontrollit të Lartë të Shtetit; nga Instituti i Statistikave është depozituar struktura dhe organika e këtij institucioni për miratim dhe nga Autoriteti i Mediave Audiovizive është paraqitur kërkesa për shkarkimin e anëtarit të këtij institucioni. Materialet do t'i gjeni të publikuara në faqen zyrtare të Kuvendit.

Fillojmë me projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr. 9426, datë 6.10.2005 “Për mbarështimin e blegtorisë”, të ndryshuar”. Për këtë projektligj janë regjistruar për të marrë fjalën deputetët: Ilir Beqaj e Bujar Çela dhe në emër të grupit të Partisë Socialiste zoti Besnik Baraj.

Fjalën e ka zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – I nderuar Kryetar i Kuvendit,

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Ky projektligj nga njëra anë është në vazhden e ndërhyrjeve të ndryshme ligjore të filluara që nga muaji shkurt kur qeveria paraqiti përpara shqiptarëve një program ambicioz për të lehtësuar dhe thjeshtëzuar procedurat sesi bëhet biznes në Shqipëri dhe sesi sipërmarrja kryen aktivitet ekonomik, ose atë që ne e kemi quajtur

proces i derregulimit. Ky program ka ardhur në Kuvend në muajin shkurt dhe vazhdimisht ne kemi pasur propozime nga qeveria që i kemi mbështetur me votë, të cilat lehtësojnë kryerjen e aktivitetit sipërmarrës në Shqipëri, madje në aspekte të ndryshme të jetës ekonomike mundësojnë që të ketë shumë më pak pengesa burokratike. Nga ana tjetër, një pjesë e mirë e procedurave kryhen sot në rrugë digjitale. Në 5-6 muajt e fundit çdo sipërmarrje, biznes i madh apo i vogël, eksportues apo importues mallrash, që ka një regjim më të veçantë kontrolli, i cili lidhet me sigurinë e shëndetit dhe sigurinë ushqimore, ka konstatuar lehtësira, ditë më të shkurtra në kryerjen e veprimeve, që nga njëra anë janë më pak shpenzime për sipërmarrjen, por nga ana tjetër bëjnë vendosjen më të shpejtë të produkteve të ndryshme në treg apo ofrimin e çmimeve të ndryshme.

Bashkë me lehtësimin për sipërmarrjet, këta muaj ka një proces shumë pozitiv në lehtësimin e vetëshërbimeve që përfitojnë qytetarët nga procesi i deregulimit dhe shtrirjes gjithmonë e më tepër të shërbimeve digjitale. Vetëm në muajin tetor, është bërë tashmë publike, se sa shumë shërbime janë ofruar në mënyrë digjitale për qytetarët, qoftë për regjistrim biznesi, qoftë marrje certifikatash lindjeje apo gjendjeje familjare, qoftë aplikim për leje ndërtimi, qoftë marrje karte shëndeti. Një aspekt shumë i veçantë pozitiv ka qenë edhe shtrirja e shërbimeve digjitale të ndihma që u jepet shqiptarëve, që jetojnë jashtë vendit, nëpërmjet e-konsullatës.

Nga ana tjetër, ky projektligj e ndihmon edhe më shumë zhvillimin e mëtejshëm të blegtorisë shqiptare. Në këto vite i gjithë sektori i bujqësisë, pra edhe bujqësia, edhe blegtoria, edhe peshkimi, ka zhvillim të vrullshëm, gjë që vërehet në rritjen shumë të madhe të eksporteve shqiptare.

Këto nuk kanë ardhur rastësisht, por nga politika të qëndrueshme, të filluara para pesë vjetësh për të nxitur prodhimin, duke dhënë mbështetje të drejtpërdrejtë financiare, duke lehtësuar kostot e prodhimit, duke mbështetur fuqimisht ujitjen, vaditjen dhe kullimin. Këtu dua të tërheq vëmendjen me një shembull shumë të thjeshtë: në gusht-shtator-tetor Shqipëria është ndeshur me një situatë thatësire jashtëzakonisht atipike, krahasuar me vitet e tjera, por impakti në

bujqësi nuk ka qenë shumë i fortë, skemat e vaditjes të mbështetura gjatë këtyre pesë vjetëve kanë dhënë rezultat, sepse për shumë më pak njësi uji kemi të njëjtin rendiment. Në qoftë se në 2013-ën ishin 120 mijë hektarë nën ujë, tashmë kemi arritur në 225 mijë, ndërkohë që për 25 mijë hektarë të tjerë janë në zbatim skema të reja mbështetëse, me një financim të miratuar në korrik në Kuvend.

Për katër vjet rresht ne kemi rritje të ndjeshme të eksporteve, me 15 % - 20 %, ndërkohë që importet janë rritur në vlera minimale, gjë e cila ka bërë që brenda bujqësisë, raporti import-eksport, nga rreth 6, 5 që e gjetëm në 2013-ën, sot ka zbritur në nivelet 3, 5 – 3, 7.

Unë besoj se, përveç mbështetjes së drejtpërdrejtë të bujqësisë, deri më tani, mbështetje pozitive ka pasur edhe në krijimin e hapësirave për zhvillim më të larmishëm ekonomik në fshat; i kemi dhënë mbështetje edhe agroturizmit, me ndryshimet e rëndësishme ligjore që sapo bëmë e që do të fillojnë të ndiehen më 1 janar 2019. Megjithatë ky rifillim i sotëm përkon me fillimin e debatit për të gjithë paketën fiskale dhe buxhetin e vitit 2019, tashmë është formësuar bindja se që nga janari i ardhshëm ne do të fillojmë me një shmangie të barrës fiskale të imputeve bujqësore, në mënyrë që për to të ketë kosto më të ulëta. Duke i shmangur për të gjithë, do të bëjmë të mundur që kjo masë të ndjehet nga çdo lloj fermeri, sado i vogël apo i madh, i formalizuar me NIPT apo ende i paformalizuar.

Besoj se kjo është një nismë që duhet përshëndetur dhe duhet miratuar me votë.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit!

Fjalën e ka kërkuar ministri i Financave, zoti Ahmetaj.

Arben Ahmetaj – Po marr shkas nga ajo që tha zoti Beqaj për sa i përket deregulimit dhe përmirësimit të të bërit biznes, që të bëj për qytetarët dhe deputetët në sallë një rezymë të diskutimeve të buxhetit, por duke iu referuar pjesës së munguar të debatit përballë, pra pjesës së opozitës.

Përpara se të kap çështjen, së cilës opozita iu referua dje, dua të them se diskutimet e buxhetit kanë hyrë në një frymë debatesh reale dhe të shëndetshme brenda maxhorancës, për të

vazhduar më tej, më shpejt, më intensivisht konsolidimin fiskal, pra uljen e borxhit publik.

Ndërkohë, dua të ndaj me ju atë që ne, si maxhorancë, kemi vendosur për sa i përket buxhetit të vitit 2019, që është ulja e deficitit në nivele rekord, pra 1, 9 % e prodhimit të brendshëm bruto. Megjithatë, nuk është kjo arsyeja specifike se përse e mora fjalën sot. Nuk është as për të rikonfirmuar bashkërendimin me Fondin Monetar Ndërkombëtar për sa i përket rritjes ekonomike, e cila do të vazhdojë të jetë mbi 4 %. Desha të kapja një çështje, të cilën opozita e ka qejf ta demonizojë. Është çështja e projekteve të partneritetit publik privat. Dua të sqaroj para qytetarëve që projektet e partneritetit publik privat janë të gjitha transparente, por unë nuk do ta kap nga kjo anë, sepse skrutinimi i procedurës do të bëhet sot, do të bëhet nesër, do të bëhet sërish e sërish ndër vite në sytë e publikut dhe në sytë e institucioneve, që duhet të merren me procedurat që ndjekin autoritetet kontraktore. Në qoftë se e patë dje opozitën, ajo iu referua një shifre për koncesionet, për partneritetin publik-privat, dhe tha se është mbi 2 miliardë euro, e cila rëndon mbi qytetarët.

Tani po i marr një për një: Rruga e Arbrit, që ka nisur me koncesion, kushton rreth 243 milionë euro. Çfarë është kjo rrugë?! Pse kjo rrugë është e domosdoshme?! Pse duhet të bëhet tani, dhe jo pas 20 vjetëve?! Sa ka kushtuar? Kjo rrugë duhet të bëhet tani, megjithëse buxheti me fondet e tij të drejtpërdrejta nuk kishte mundësi ta bënte. Ndaj hymë në partneritet publik-privat, një procedurë totalisht transparente. Çfarë bën të mundur, sepse nuk po merrem përsëri me procedurën? Bën të mundur që dibranët dhe e gjithë zona që preket nga rruga të mos presin 20 vjet për rrugën. Ajo që tha dje opozita, po, është e vërtetë, janë investimet publike në favor të qytetarëve. Po e pyes opozitën: çfarë ke me dibranët, që nuk do që t'u bëhet rruga?! Si e ke punën me dibranët, që nuk do që ata të kenë një rrugë dinjitoze për të ardhur në Tiranë apo për t'u lidhur edhe me Shkupin nesër, në aspektin tregtar, apo të lidhen sot me Durrësin, në aspektin tregtar? Çfarë keni me qytetarët e Dibrës?! Çfarë ju kanë bërë qytetarët e Dibrës? Nuk ju dhanë katër vota në parlament?! Nuk jua dhanë se nuk i meritoni dhe ju nuk e gjykoni dot sovranin.

Çfarë keni me popullin e Shkodrës?! Thumanë-Kashar është vazhdimi i Rugës së Kombit. Çfarë keni me kuksianët? Çfarë keni me shkodranët që nuk doni që t'u bëhet rruga?! Çfarë arsyesh keni përtej kësaj? Doni ta lini vendin në mjerim?! Pse nuk doni që Shkodra të ketë një autostradë më dinjitoze, të lidhet me Tiranën dhe me Durrësin, apo me kë të dojë? Çfarë doni që populli i Balldrenit dhe i gjithë Veriut të mos ketë rrugë dinjitoze? Cila është arsyeja? Kë urreni: Shkodrën, që nuk ju dha 7 vota?! Nuk i meritoni! Lezhën, që nuk ju dha 5 vota?! Nuk i meritoni! Ia dhanë Partisë Socialiste. Kjo është arsyeja pse i urreni dhe i ngrini koncesionet? Koncesionet janë investime publike në favor të qytetarëve.

Ju të opozitës çfarë keni me të sëmurët me dializë?! Çfarë keni që doni t'i bëni të vuajnë?! Çfarë keni me ta që doni t'i bëni të vuajnë, përtej vuajtjes që kanë? Çfarë keni?! Cila është arsyeja pse nuk doni që ata të marrin shërbim; nuk doni të marrin shërbim ashtu siç duhet të marrin; nuk doni që të marrin shërbim aty ku e marrin?! Dikur ka qenë me 80 mijë lekë dhe sot është falas, por ju nuk doni. Pse nuk doni?! Çfarë interesi keni që ata të vuajnë, përtej vuajtjes që kanë?! Pse nuk doni që të sterilizohen pajisjet në spitale, ashtu siç i ka hije një spitali normal?! Pse doni që të infektohen ata të pafat që shkojnë aty për shkak të sëmundjes?! Cila është arsyeja? Këto janë koncesionet. Pse nuk doni që qytetarët të shkojnë të kontrollohen, të bëjnë *check up* falas?! Cila është arsyeja? Çfarë keni me shëndetin e qytetarëve? I keni vënë çmim jetës?!

Pse nuk doni të pastrohen plehrat e Tiranës? Cila është arsyeja? Keni probleme të procedurës dhe të kostos? Aty e keni?! Aty do të jenë letrat, aty është procedura, do të shikohen sot, do të shikohen nesër dhe do të shikohen ndër vite.

Çfarë keni me popullin e Vlorës? Nuk doni që të bashkohet me Himarën?! Çfarë keni me popullin e Gjirokastrës, që nuk doni të bëhet bajpasi? Çfarë problemi keni? Ah, ju doni koncesionet e huave fiskale, doni koncesionet e skanimit! Ato doni ju?! E dini sa u kushton shqiptarëve koncesioni i skanimit?! Jemi i vetmi vend në Europë që e bën.

Rrugë me koncesion, me PPP-i, bën gjithë bota dhe e gjithë Europa. Shërbime spitalore bën e gjithë Europa dhe e gjithë bota. Skanim bëri

vetëm Shqipëria në të gjithë Bashkimin European dhe në Europë. Vendi pararojë me skanim. E dini sa i kushton biznesit?! Biznesit i kushton 22 milionë euro, në fakt, i kushtonte 40, por ia ulëm ne. Po buxhetit e dini sa i kushton? 19 milionë dollarë. Këta flasin për koncesione. E dini që pullat fiskale ka raste që janë më shtrenjtë se akciza?! Pra, këto koncesione duan këta. Ne bëjmë koncesione për Rugën e Arbrit, për Rugën e Kombit, rrugën e Shkodrës, rrugën e Vlorës, dializën, *check up*-in, inceneratorët kundër plehrave. Apo doni që njerëzit të mbyten, të vijnë si zombi dhe pastaj t'ju votojnë ju nga Azia?! Janë shërbime publike. Dua që ta dëgjojnë qytetarët, sepse dalin dhe recitojnë aty: koncesione, PPP-i. Rrugat e Arbrit është partneritet publik-privat. Me paratë e buxhetit do të bëhej pas 20 vjetëve, por jo do të bëhet tani, sepse i duhet Dibrës dhe i duhet Shqipërisë. Po, do ta paguajë buxheti për 13 vjet, patjetër. Do të bëhet edhe Balldreni, patjetër do të bëhet edhe Thumanë-Kashar, patjetër do të bëhet dhe Tiranë-Durrës, është arteria kryesore e vendit dhe do të paguhet ndër vite, për 15 vjet. Tiranë-Durrës do të bëhet me TOLL, asnjë lek nga buxheti i shtetit.

Pse i demonizojnë? E dini pse?! Po ju bëj një llogari të shkurtër. Çdo shërbim, çdo rrugë, çdo aset, çdo investim që bën kjo maxhorancë i vret këta, se largohen nga pushteti, ngelen aty te 20%-shi që kanë ngrirë, ndërsa ne nuk i masim me numër votash, i masim me përgjegjshmëri ndaj tetarëve. Të dalin dhe të më thonë: çfarë kanë me popullin e Dibrës, me popullin e Shkodrës, me popullin e Durrësit, çfarë kanë me të sëmurët me dializë, çfarë kanë me ata që shkojnë në spitale, pastaj aty i kanë procedurat, le t'i kontrollojnë ndër ditë, ndër javë dhe ndër vite.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Ahmetaj!

Fjala për zotin Çela.

Bujar Çela – I nderuar zoti Kryetar,

Të nderuar kolegë,

Të nderuar blegtorë dhe përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë, që keni sjellë këtë ndryshim të vogël në ligjin për mbarështimin e blegtorisë.

Në fakt, ky është një ndryshim i vogël, të cilin e ka diktuar koha në lidhje jo me

inseminimin artificial, por me ndërzimin natyral për shtimin dhe për ruajtjen e metodave bio. Ky është i vetmi prodhim, që unë mendoj se i ndihmon blegtorët dhe fermerët për të pasur shpenzime sa më të pakta për mirëmbajtjen e familjes.

Nëse flasim për turizmin, nuk duhet harruar që prodhimet blegtorale janë ato që tërheqin më shumë turistët në Shqipëri, të cilat janë me të vërtetë bio, sepse kafshët rriten e kullohen ende në kodra, male e pellgje, jo në komplekse moderne, sepse komplekset moderne ata i kanë më të mira se tonat.

Unë dua t'i tërheq vëmendjen Ministrisë së Bujqësisë për disa probleme që kanë këta blegtorë. Ata kanë një problem të mbartur, siç është matrikulimi. Ne vërtetë flasim për prodhimet bio, por a e dini sa dobët jemi në këtë pikë, pra në matrikulimin e viçave të sapolindur? A e dini se kur matrikulohen këta për herë të parë dhe të fundit?! Ditën e therjes. Ky është një defekt shumë i madh. Ne duhet të subvencionojmë lindjen e çdo viçi dhe krerëve të tjerë ashtu siç subvencionojmë edhe prodhimet e tjera, jo thjesht komplekset e mëdha, ku përfitojnë fermerët e mëdhenj, por duhet të përfitojnë blegtorët e vegjël, të cilët i kemi me shumicë.

Çdo ditë para se të shkojnë në thertore, ata hasen edhe me një problem tjetër, siç janë raportet veterinarë. Fermeri, megjithëse e ka rritur bagëtinë, e ka të vështirë të sigurojë raportin veterinar. Pse ndodh kjo? Sepse Shërbimi Veterinar i Drejtorisë së Bujqësisë, shërbimi veterinar i bashkive dhe i njësive administrative është shumë larg. Në këto zona ende punojnë teknikë të mesëm, punonjës të thjeshtë, të cilët duan të ushqehen, por njëkohësisht duan t'u shërbejnë edhe komshinjve, që bashkëjetojnë me ta.

Një problem tjetër është edhe mosha e therjes së këtyre kafshëve. Ne realisht nuk hamë mish viçi bio, sepse viçi theret 3 muajsh, që është një krim i vlerave ushqyese, sepse nuk është në kulmin e tij. Ditën që viçi lë qumështin, theret dhe ai nuk është mish me vlera të plota ushqimore.

Këto janë probleme, të cilat duhet të jenë në vëmendje të Ministrisë së Bujqësisë, të drejtorisë e posaçme të veterinarisë dhe blegtorisë. Bashkëpunimi me Institutin Bujqësor, sidomos

me Fakultetin e Veterinarisë, duhet të jetë në një shkallë edhe më të lartë.

Këto janë probleme të qytetarëve dhe të njerëzve tanë, të cilët punojnë për vete, por edhe për të mëkëmbur ekonominë tonë në tërësi.

Ne kemi ende probleme me titujt e pronësisë, të cilave po u mbaron afati, 31 dhjetor, jemi shumë mbrapa. Puna e bërë nga pushteti vendor së bashku me Ministrinë e Bujqësisë nuk është në nivelin e duhur dhe lë për të dëshiruar.

Ne vazhdojmë të flasim për tokën, vaditjen dhe kullimin, për të cilat ka shumë investime, por realisht ato nuk shfrytëzohen mirë nga formacionet që ne kemi ndërtuar, duke prishur ato të së shkuarës.

Pavarësisht këtyre që përmenda, të cilat janë në emër të atyre që punojnë, unë kam besim të plotë se programi ynë është i duhuri dhe do të shkojë sa më afër njerëzve të punës.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Çela!

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, fjalën e ka zoti Baraj.

Besnik Baraj – Duke ju falënderuar, pas fjalës së zotit Beqaj dhe zotit Çela unë nuk kam se çfarë të shtoj për këtë projektligj. Bëhet fjalë për një projektligj në kuadër të reformës derregullatore për të krijuar një klimë sa më të përshtatshme dhe nxitëse për biznesin, për t'i hequr dhimbjet e kokës në kuadër të shumë masave të tjerave që janë ndërmarrë. Kështu që nuk më mbetet të them gjë tjetër, vetëm ju ftoj për ta votuar.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Baraj!

Këtu mbyllet diskutimi për projektligjin “Për mbarështimin e blegtorisë”, i ndryshuar.

Vazhdojmë me projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar”.

Në emër të grupit të Partisë Socialiste fjalën e ka zoti Manja.

Ulsi Manja- Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar”, të cilin do ta votojmë sot, është pjesë e paketës së dytë të ligjeve të reformës në drejtësi, si pjesë përbërëse e reformimit të sistemit të drejtësisë penale në vend. Cili është qëllimi i këtij

projektligji? Ky projektligj ka për qëllim të përmirësojë procesin e ekzekutimit vullnetar, si dhe të rrisë rolin mbikëqyrës të shërbimit të provës në ekzekutimin e vendimeve penale.

Analiza e sistemit të drejtësisë ka evidentuar një sërë problematikash për sa i takon ekzekutimit të vendimeve penale, që lidhen kryesisht me mënyrën e njoftimit të të dënuarve, të cilët gjatë ekzekutimit vullnetar, gjatë fazës së hetimeve apo gjykimit kanë qenë në gjendje të lirë apo me masë sigurimi “Arrest shtëpie”; me mbikëqyrje nga shërbimi i provës të personave me masë sigurimi “Arrest shtëpie”; me ekzekutimin e vendimeve në rastet kur i dënuari ndryshon adresën e vendbanimit të tij; me periudhën e fillimit të vuajtjes së dënimeve alternative, si dhe me ekzekutimin e vendimeve me masa mjekësore dhe edukuese të dhëna me vendim gjyqësor. Për adresimin e problematikave dhe gjetjeve të evidentuara nga Analiza e Sistemit të Drejtësisë dhe për përmirësimin e kuadrit rregullator, i cili rregullon mënyrën e ekzekutimit të vendimeve penale, në Strategjinë e Reformës në Drejtësi dhe në Planin e saj të Veprimit u parashikua miratimi i disa shtesave dhe ndryshimeve në këtë ligj.

Me këtë projektligj, ndër të tjera, synohet përmirësimi i kuadrit ligjor ekzistues në lidhje me ekzekutimin e masave edukuese e mjekësore, si dhe krijimi i institucioneve të posaçme për ekzekutimin e këtyre masave; garantimi i ekzekutimit të drejtë të vendimeve gjyqësore, në respektim të parimit të lirisë dhe të sigurisë së personit; ridimensionimi i rolit të gjykatës dhe prokurorit në ekzekutimin e dënimeve penale, duke synuar rritjen e efektshmërisë së sistemit të ekzekutimit; krijimi i mekanizmave ligjorë dhe institucionalë të pajisur me burimet e nevojshme materiale dhe njerëzore për trajnimin e kualifikimin e vazhdueshëm profesional të stafit të administratës së institucioneve penitenciare dhe Shërbimit të Provës.

Projektligji, që do të votojmë sot në seancë plenare, i është nënshtruar një procesi të gjerë konsultimi, me qëllim garantimin e transparencës dhe gjithëpërfshirjes në procesin e vendimmarrjes. Në këtë kuadër, projektligji u është përcjellë për mendim jo vetëm institucioneve që kanë në fushën e përgjegjësisë së tyre zbatimin e detyrimeve të lidhura me ekzekutimin e vendimeve penale, por edhe

organizatave ndërkombëtare e përfaqësuesve të shoqërisë civile.

Të gjitha komentet dhe sugjerimet e mbledhura gjatë procesit të konsultimit janë marrë në shqyrtim nga grupi i punës, i përbërë nga ekspertë të misionit EURALIUS, të Ministrisë së Drejtësisë, të Prokurorisë së Përgjithshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Shërbimit të Provës dhe OSBE-së, me qëllim reflektimin e tyre dhe paraqitjen e një projektligji sa më të konsoliduar që adreson dhe zgjidh të gjitha problematika, të cilat janë hasur nga Analiza e Sistemit të Drejtësisë në lidhje me ekzekutimin e vendimeve penale.

Cilat janë risitë e këtij projektligji? Risitë e variantit integral të miratuara në Komisionin përgjegjës për Çështjet Ligjore janë të lidhura me harmonizimin e këtij projektligji me Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale dhe Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur, që janë miratuar në kuadër të reformës në sistemin e drejtësisë; me përcaktimin e qartë dhe të saktë të elementeve që duhet të përmbajë akti procedural, mbi bazën e të cilit fillon ekzekutimi i vendimit penal, si dhe saktësimin e përgjegjësisë së prokurorëve të seancës sipas shkallëve të gjykimit, me qëllim shmangien e problematikave të evidentuara në praktikë; me parashikimin e garancive ligjore të lidhura me njoftimin e të miturit të dënuar, si dhe me ekzekutimin e masave edukuese në harmoni me Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur; me rregullimin e detajuar të mbikëqyrjes së ekzekutimit të vendimit të dënimit me qëndrim në shtëpi, si dhe përcaktimi i procedurës në rastet e ndryshimit të vendbanimit nga i dënuari me qëndrim në shtëpi; me reflektimin e ndryshimeve të miratuara së fundi në Kodin Penal, në dispozitën që parashikon rastet e vendimeve që ekzekutohen menjëherë, siç është rasti i pezullimit të dënimit me burgim dhe vënia nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës, si dhe me qartësimin e rregullave lidhur me mënyrën e zbatimit të urdhërimit të gjykatës për lirimin e menjëhershëm.

Në këtë kontekst, projektligji parashikon në mënyrë të qartë përgjegjësitë e prokurorit dhe të institucionit të ekzekutimit të vendimit penal, adresimin dhe zgjidhjen e paqartësive ligjore të konstatuara në praktikë gjatë ekzekutimit të vendimeve, të cilat parashikojnë dënime

alternative në lidhje me momentin e fillimit të vuajtjes së dënimeve alternative, së fundi përmirësimin e procedurave të ekzekutimit të vendimeve të gjykatës për rastet e nxjerrjes jashtë territorit të personave të huaj dhe pa shtetësi, duke reflektuar parashikimet e bëra në legjislacionin në fuqi për të huajt në Republikën e Shqipërisë.

Për të gjitha këto arsye, të nderuar kolegë deputetë, ju ftoj ta votojmë pa vonesë këtë projektligj, i cili është një nga projektligjet e fundit të paketës së dytë të reformës në drejtësi, që i referohet sistemit të drejtësisë penale.

Edhe një herë faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Manja!

Mbyllet këtij diskutimi për projektligjin për ekzekutimin e vendimeve penale.

Vazhdojmë me projektligjin “Për disa shtesa në ligjin nr. 9584, datë 17.07.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar”.

Në emër të Grupit Parlamentar të PS-së, fjalën e ka zoti Bushati.

Ervin Bushati – I nderuar zoti Kryetar,

Të nderuar kolegë,

Është shumë e rëndësishme, sidomos tani që diskutojmë buxhetin, të flasim për institucionet e pavarura dhe për mënyrën sesi funksionojnë ato. Në të gjitha diskutimet që kemi pasur për buxhetin, për ne ka qenë kryesore, në radhë të parë, të flasim për institucione, të cilat gjithmonë e më shumë largohen nga orbita e politikës institucionale që të funksionojnë të pavarura në shërbim të qytetarëve në shërbim të ekonomisë dhe shoqërisë për të kryer misionin, për të cilin ato janë krijuar, si dhe për të shërbyer sa më mirë. Prandaj më vjen keq që gjatë këtyre ditëve, kur po flitet për ligjin më të rëndësishëm të shtetit, që është projektbuxheti i vitit 2019, opozita nuk ka qenë e pranishme. Nuk ishte e pranishme as për ligjin e lojërave të fatit, i cili ishte i rëndësishëm dhe kishte të bënte në mënyrë direkte me shoqërinë shqiptare, me këtë plagë që ka shoqëria shqiptare. Opozita ka vendosur të qëndrojë jashtë kësaj sale dhe jashtë të gjitha mbledhjeve që kemi zhvilluar në komisione. Në mënyrë të vazhdueshme kemi diskutuar për çështje të rëndësishme, kemi folur për buxhetin, kemi folur për rritjen ekonomike,

kemi folur për mënyrën sesi mund të funksionojë më mirë biznesi, si mund të rritet punësimi, por opozita ka vendosur herë pas here dhe në mënyrë të vazhdueshme të mos përgjigjet dhe të mos i adresojë problematikat që ka shoqëria shqiptare. Është e papërgjegjshme mënyra sesi opozita del e bën deklaratat, mban qëndrime politike dhe jep opinione për ligje, të cilat as nuk i ka lexuar. Më vjen keq, sepse, edhe kur u diskutua ligji për bastet, ashtu siç po diskutohet edhe këto ditë nëpër komisione në mënyrë intensive edhe për buxhetin e vitit 2019, opozita vazhdon të mungojë dhe nuk ka lexuar çështjet bazike, të cilat diskutohen sot për buxhetin.

Para një viti kemi qenë në këtë sallë dhe më kujtohet kur opozita i ra kambanës së alarmit, ashtu siç i ka rënë edhe 100 herë të tjera, duke thënë se Shqipëria do të merrte fund, se kjo qeveri kishte rënë, se ky ishte buxheti i pastrimit të parave, se do të pastroheshin paratë e drogës, se ky shtet do të falimentonte brenda gjashtë muajve, se do të kriminalizohej e gjithë ekonomia. Që të gjitha kambana alarmi të rëna më kot.

Sa herë ka pasur diskutime të rëndësishme, opozita i ka shmangur ato. Ajo ka shmangur detyrimin për të pasur një proces diskutimi për përmirësimin e legjislacionit, duke i vënë atij një stampë apo një vulë politike të përgatitur, të gatuar që më parë në zyrat e saj kryesore.

Është e drejta e çdo opozite, ashtu si në çdo vend të botës, është prerogativë që të mos jetë dakord as me qeverinë, as me buxhetin. Janë dy veprimet më politike që ka çdo maxhorancë: zgjedhja e qeverisë dhe miratimi i buxhetit, por kjo nuk do të thotë që opozita të mos vijë të thotë argumentet e saj, të japë një alternativë dhe, pse jo, të dëgjohet për çështjet që kanë të bëjnë me përmirësimin e jetës së qytetarëve.

Ne kemi qenë gjithmonë të hapur dhe shpeshherë, kur opozita ka qenë në komisione, kemi marrë parasysh pyetjet, kemi dhënë përgjigje, kemi marrë parasysh vërejtjet e tyre e pse jo, kemi marrë edhe ndonjë pjesë të propozimeve të tyre, kur ato kanë qenë të vlefshme dhe kemi votuar bashkë me ta.

Ndaj është për të ardhur keq që në këto ditë, kur po diskutohet për buxhetin, për ekonominë shqiptare, për mirëqenien e të gjitha familjeve shqiptare, për institucionet e pavarura, për mënyrën se si do të ndahen investimet,

opozita nuk vjen dhe nuk merr pjesë në këtë proces.

Shpresoj që opozita shqiptare të fillojë të vijë e pse jo, ka akoma kohë që në votimin në parim të projektbuxhetit 2019, që do të bëhet javën që vjen, të reflektojë, jo sepse na duhet dhe na shërben vetëm neve në këtë sallë.

Unë jam i bindur që, si qeverisë, edhe këtij krahu të maxhorancës i bën më mirë një opozitë konstruktive, e cila ka detyrime ndaj qytetarëve të këtij vendi, që e kanë votuar. Opozita, sidomos Grupi Parlamentar i PD-së, paguhet me lekët e taksapaguesve për të qenë në parlament, për të kontribuar, për të diskutuar dhe për të sjellë alternativën e vet.

Në qoftë se opozita do ta kryente këtë detyrë, sepse në radhë të parë u detyrohet qytetarëve, ajo do të përpiquej të përmirësonte me aq sa mundej, me argumentet që ka, edhe ligjet që ne sjellim në parlament. Atëherë, do ta kryente dyfish misionin që ka ndaj këtij vendi.

Diskutimet për buxhetin në Komisionin e Ekonomisë dhe në të gjitha komisionet e tjera vazhdojnë. Unë shpresoj që kjo ftesë e singertë nga kjo foltore e nderuar të shkojë në veshët e atij që merr vendimet apo të dyshes që merr vendimet. Unë nuk jam i sigurt se kush i merr vendimet, kryetari aktual apo zoti Berisha. Le të ulen bashkë dhe të vendosin apo le ta instruktojë zoti Berisha zotin Basha, që opozita i duhet Shqipërisë dhe ne të gjithë bashkë, si qytetarë të këtij vendi, të bëjmë detyrën në parlament.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi - Faleminderit, zoti Bushati!

Këtu mbyllet edhe diskutimi i projektligjit "Për disa shtesa në ligjin nr. 9584, datë 17.7.2006, "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj"". Çfarë kishit zoti Fino?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pyetje për kë?

Bashkim Fino – Kisha pyetje për projektligjin, që sapo kaloi.

Gramoz Ruçi – Jo, këtu kanë mbaruar pyetjet.

Bashkim Fino – Atëherë, kam për të diskutuar.

A mund të them diçka?

Gramoz Ruçi – Jo. Ai foli në emër të grupit, kështu që duhej të regjistroje emrin për të marrë fjalën. Janë mbyllur diskutimet dhe nuk ke çfarë të flasësh.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të thashë që foli në emër të grupit. Jo!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ai është një problem tjetër.

Jo, është detyra ime që të zbatoj Rregulloren.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Je në kundërshtim me Rregulloren. Nuk bëhen pyetje për projektligjin kur përfundon diskutimi në emër të grupeve.

Kalojmë në shqyrtimin e projektligjit "Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit që ndryshon memorandumin e mirëkuptimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e drejtësisë të Bashkimit Europian".

Nuk ka diskutantë të regjistruar.

Fjalën e ka zoti Anduel Xhindi në emër të grupit!

Anduel Xhindi – Faleminderit, zoti Kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji "Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit, që ndryshon memorandumin e mirëkuptimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e drejtësisë të Bashkimit Europian", ka për qëllim ofrimin e asistencës për zbatimin e legjisllacionit të BE-së për identifikimin dhe përjashtimin e substancave psikoaktive të reja, riintegrimin dhe rehabilitimin e përdoruesve të drogës duke përfshirë edhe ata që e kanë vuajtur dënimin në institucionet e ekzekutimit të dënimeve penale, si dhe zhvillimin e metodologjive të përbashkëta të autoriteteve publike në nivel lokal apo rajonal dhe të shoqërisë civile, me qëllim uljen e numrit të veprave penale të lidhura me drogën.

Implementimi i tij do të mundësojë rritjen e efikasitetit të institucioneve ligjzbatuese në luftën kundër lëndëve narkotike.

Lufta kundër drogës është një betejë e ashpër dhe nuk njeh kufij, ndaj përpjekjet për të

fituar këtë betejë mund të bëhen efikase vetëm nëpërmjet bashkëpunimit me partnerët tanë të BE-së. Kjo luftë është një luftë që më së pari fitohet në mendje, para se të fitohet në rrugë, para se të fitohet atje, ku kultivohet droga.

Qeveria shqiptare e njeh dhe e pranon natyrën serioze të këtij problemi, si në nivelin kombëtar, ashtu dhe në atë ndërkombëtar, si dhe pranon faktin se në luftën kundër drogave mund të jemi të suksesshëm vetëm nëse koordinojmë përpjekjet tona, ato të qeverisë me përpjekjet e partnerëve ndërkombëtarë.

Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje të rëndësishme, që ndryshon memorandumin e mirëkuptimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e drejtësisë së Bashkimit Europian, është një hap pozitiv, që ndiqet edhe në kuadrin e procesit të stabilizim-asociimit dhe të plotësimit të detyrimeve, që na linden, në bazë të kapitullit 24 të MSA-së.

Projektakti është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si dhe me ligjin “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Shqipëria ka qenë e përfaqësuar nga Ministria e Drejtësisë dhe e ka nënshkruar memorandumin e mirëkuptimit më 23 shtator 2016. Më pas ky memorandum është ratifikuar me ligjin nr. 11/2017. Ai përfshinte 3 komponentët, që i përkasin fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë, ndërkohë që nuk përfshinte pjesën e katërt të komponentit, që lidhet me politikën e luftës kundër drogave.

Pjesa e komponentit të luftës kundër drogave, të këtij memorandum, lidhet kryesisht me asistencën financiare dhe i përket Ministrisë së Brendshme. Pra, në thelb, ndryshimi i këtij memorandum është thjesht ofrimi i një asistence financiare, që ofrohet me një shumë të përcaktuar. Kjo asistencë është e ndarë në vite dhe do t’i dedikohet Ministrisë së Brendshme për komponentin që i përket kësaj ministrie.

Kontributi financiar, që duhet të paguhet nga Shqipëria në buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Europian, për të marrë pjesë në bashkëpunimin gjyqësor, trajnimin gjyqësor dhe aksesin në linjat e programit të drejtësisë, do të jetë si më poshtë vijon:

- Për vitin 2017 parashikohen 41674 euro (duke përfshirë 6000 euro për objektivin (d) që i përket Ministrisë së Brendshme).

- Për vitin 2018 parashikohen 43260 euro (duke përfshirë 6000 euro për objektivin (d) që i përket Ministrisë së Brendshme).

- Për vitin 2019 parashikohen 44974 euro (duke përfshirë 6000 euro për objektivin (d) që i përket Ministrisë së Brendshme).

- Për vitin 2020 parashikohen 46662 euro (duke përfshirë 6000 euro për objektivin (d) që i përket Ministrisë së Brendshme).

Efektet financiare për pjesën e katërt të komponentit (d) “Politika e luftës kundër drogave”, që do të mbulohen nga Ministria e Brendshme, janë 6000 euro për secilin vit buxhetor dhe do të përballohen nga buxheti i programit “Policia e Shtetit”.

Nisur nga qëllimi i kësaj marrëveshjeje, ftoj kolegët ta miratojmë.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Xhindi!

Vazhdojmë me ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, fjalën e ka zoti Luan Duzha.

Luan Duzha – I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuara familje të prekura drejtpërsëdrejti nga mungesa e rëndë e një personi të dashur, çka e bën të shkuarën tuaj të rëndë një histori dhimbjesh e padrejtësish,

Dua që fjalën time ta nis me një urim të singertë: uroj fort që marrëveshja e sotme ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Ndërkombëtar të Gjetjes së Personave të Zhdukur të jetë sadopak në formën e një përgjigjeje për shpresat dhe lutjet e dhjetëra apo qindra familjeve shqiptare, që shpresonin se një ditë do ta mësonin plotësisht fatin e keq të të afërmeve të tyre, në këmbim vetëm të një vendi ku ata të prehen në paqe!

E shkuara na njohu me një realitet të errët: familje pa një vend për të qarë familjarin; eshtra pa një vend tretjeje, konform normave zakonore të traditës së shqiptarit; jetë njerëzish të ndërprera në mënyrë të mbrapshtë dhe për arsye

edhe më të mbrapshta. Kjo e shkuar rëndonte mbi ndërgjegjen kolektive. Kjo ndërgjegje kolektive e lënduar rëndonte çdo ditë mbi “supet” e institucioneve tona përgjegjëse. Çdo ditë, pasi sistemi totalitar ra, ishte një ditë e shtuar përgjegjësie për mosgjendjen pranë dhembjes së dhjetëra e qindra familjarëve shqiptarë, në Veri e Jug të vendit, që nuk i gjetën kurrë eshtrat e familjarëve të tyre.

Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe ICMP-së për gjetjen e personave të zhdukur përgjatë periudhës së sistemit të shkuar totalitar (29.11.1944 – 02.07.1991) është një reflektim i thellë e serioz, një hap përpara dhe konkret drejt një reagimi kaq të shumëpritur, dhe institucional, që një shtet serioz bën ndaj qytetarëve, ndaj dhimbjes dhe lëndimit të tyre, sado i shkuar në kohë qoftë ky burim dhimbjeje.

Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur e ngre Shqipërinë në një nivel proaktiv veprimi me metodat më bashkëkohore, eficiente dhe efikase, që shtete të tjera me përvoja të ngjashme kanë ndjekur me sukses.

Gjetja e personave të zhdukur, në përvojën e Komisionit Ndërkombëtar prej dy dekadash nuk konsiderohet si një sipërmarrje kombëtare, përkundrazi, për personat e humbur, si në rastet e konflikteve të armatosura; në rastet e fatkeqësive natyrore apo në rastet e pasojave të shkeljes së të drejtave të njeriut, siç është rasti i Shqipërisë, veprimi më efikas është ai në nivel partneriteti ndërkombëtar, duke e trajtuar globalisht sfidën e gjetjes së personave të zhdukur.

Aplikimi i arritjeve të fundit shkencore dhe teknologjike, me fokus gjetjen dhe identifikimin e trupave, bëhet më i lehtë nëse reagimi bëhet falë koordinimit në nivel ndërkombëtar.

Përvoja e Komisionit Ndërkombëtar të Gjetjes së Personave të Zhdukur ka treguar në dekadën e fundit se zhvillimet dhe zbulimet në gjenetikë, përdorimi i metodave moderne të mjekësisë ligjore dhe krijimi i një databaze të dedikuar përtej kufijve kombëtarë prodhon mundësi të reja rezultatesh, të pamenduara më parë. Ky kapitull rezultativ shënon hapat e parë të suksesit në një përvojë të afërt me tonën, Ballkanin, vendet e ish-Jugosllavisë, të cilat, për shkak të konflikteve të armatosura, humbën pa adresë familjarët e tyre. Dhjetëra e qindra familje

kosovare pritën eshtrat e familjarëve të zhdukur, po kështu kroatë, boshnjakë e të tjerë.

70% e 40 mijë të humburve të përlllogaritur në këtë konflikt, falë metodave që listova më sipër dhe ndërhyrjes së Komisionit, u identifikuan. Kjo qasje bëri të mundur edhe identifikimin e shumë prej viktimave të sulmeve të “11 Shtatorit”. Suksesi i tij vlerësohet edhe në përlllogaritjen dhe identifikimin e viktimave të cunamit të vitit 2004 në Azinë Juglindore. Në Argentinë, Kili dhe Afrikën e Jugut ka pasur zhvillime mjaft pozitive falë metodikës se si Komisioni Ndërkombëtar qaset në raste të tilla.

Ndaj, të nderuar kolegë, ardhja në Tiranë e ICMP-së, që do të krijojë një zyrë shërbimi për gjetjen e personave të zhdukur, duke përdorur metodat tekniko-shkencore të zbulimit, të identifikimit dhe të shkëmbimit të informacionit me organet kompetente, në kuadër të koordinimit dhe të bashkëpunimit, me qëllim realizimin e aktivitetit administrativ, e fut Shqipërinë në radhën e 40 vendeve nga pesë kontinentet, ku Komisioni operon me rezultate të larta. Komisioni operon me sukses në mjedise të ndryshme me njëri-tjetrin nga pikëpamja shoqërore, politike ose kulturore. Rezultatet e tij kanë qenë përherë bindëse në drejtim të lokalizimit dhe identifikimit të të humburve.

Si në Amerikën e Veriut, në Amerikën e Jugut, në Europë, kryesisht në Ballkan, po ashtu edhe në Afrikën e Veriut dhe në Lindjen e Mesme e të Largët, Komisioni është përpjekur maksimalisht të nxisë edhe përfshirjen e shoqërisë civile për ngritjen e kapaciteteve teknike dhe institucionale të vendeve ku operon.

Për këto arsye, me bindjen e plotë se kjo marrëveshje do të sjellë rezultatet e shumëpritura për të lehtësuar sadopak barrën emocionale dhe psikologjike të një numri të konsiderueshëm familjesh shqiptare, ftoj kolegët e mi deputetë ta mbështesin pa mëdyshje këtë marrëveshje, duke e konsideruar me rëndësi të dorës së parë, çka do të meritonte edhe praninë në sallë të opozitës parlamentare.

Siç e theksova edhe në fillim të fjalës sime, dëshiroj shumë që rezultatet të mos vonojnë dhe dhimbja e zgjatur e familjarëve, në pamundësi të një shërimi të plotë, të ketë një lehtësim të ndjeshëm të saj.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Duzha!

Vazhdojmë me diskutimet për projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2017, për projektin “Promovimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes fondit të garancisë së kredive rurale”.

Janë regjistruar për të diskutuar zonja Dhima, zoti Suli dhe në emër të grupit zoti Ervin Bushati.

Fjalën e ka zonja Dhima.

Antoneta Dhima – I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë dhe deputete,
Të dashur qytetarë,

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, shqyrtoi dhe miratoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2017, për projektin “Promovimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes fondit të garancisë së kredive rurale”, i propozuar nga Këshilli i Ministrave në përputhje me nenet 81, pika 1, 100 dhe 121 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Kjo marrëveshje është miratuar në parim me vendim nr. 487, datë 31. 7. 2018 të Këshillit të Ministrave dhe ka si qëllim dhënien e shumës financiare prej 5 milionë euro për përmbushjen e objektivit të inkurajimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme mbi një bazë të qëndrueshme, duke garantuar kreditë tregtare të institucioneve mikrofinanciare, të cilat do t’u ofrojnë kredi kredimarrësve në segmentin bujqësor e rural të ekonomisë, që ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e konkurrueshmërisë së tyre dhe krijimin e vendeve të reja të punës në bujqësi.

Gjatë gjithë kohës marrëdhëniet midis Gjermanisë dhe Shqipërisë janë zhvilluar dhe po zhvillohen drejt një partneriteti të qëndrueshëm dhe shumë miqësor. Tashmë Shqipëria është pjesë e familjes së madhe europiane dhe Gjermania është një nga vendet që e mbështet atë në rrugën e saj drejt integritetit në Bashkimin Europian.

Prej shumë vitesh Gjermania është donatori më i madh i Shqipërisë, në kuadër të bashkëpunimit për zhvillim, dhe një nga

partnerët më të rëndësishëm tregtarë. Që prej vitit 1988 Gjermania e ka mbështetur dhe po vazhdon ta mbështesë Shqipërinë me më shumë se 1 miliard euro, përfshirë këtu kontributin e Bashkimit Europian dhe të Kombeve të Bashkuara.

Duhet theksuar se është investuar në të gjithë fushat, si në zhvillimin ekonomik, energjetik, infrastrukturë ujore, arsim dhe formim profesional dhe në zhvillimin e zonave rurale dhe urbane. Po kështu, edhe nga pikëpamje kulturore Gjermania është angazhuar si kurrë më parë, duke akorduar financime për mbështetjen e programeve të ndryshme zhvillimore në vend. Falenderime dhe mirënjohje pa fund për mbështetjen e vazhdueshme që Gjermania i ka dhënë Shqipërisë ndër vite në avancimin e proceseve të rëndësishme politike, në aspektin ekonomik, mbështetjen financiare për projekte të ndryshme apo edhe për mbështetjen teknike.

Marrëdhëniet midis dy vendeve tona janë shumë të mira dhe qeveritë do ta shfrytëzojnë bashkarisht potencialin ekzistues në funksion të zgjerimit të mëtejshëm të marrëdhënieve gjermano-shqiptare edhe gjatë viteve në vazhdim.

Nënshkrimi i marrëveshjes që ne po diskutojmë sot, konfirmon edhe një herë marrëdhëniet e shkëlqyera që Shqipëria ka me Republikën Federale të Gjermanisë.

Marrëveshja ka interes si në aspektin ekonomik, ashtu edhe në atë social, duke marrë në konsideratë nevojën për mbështetje financiare dhe shtysat e mëtejshme në fushën e promovimit të ndërmarrjeve të vogla e të mesme. Institucionet përgjegjëse për zbatimin e kësaj marrëveshjeje janë Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Fondi Rural i Garancisë së Kredive .

Prej disa ditësh kam ndjekur me vëmendje protestën e banorëve, pronat e të cilëve do të preken nga projekti i zgjerimit të Unazës së Madhe në segmentin nga Fabrika e Miellit deri te Dogana, si dhe kam dëgjuar po me vëmendje të gjitha komentet e bëra për heqjen e monumentit të shqiponjës nga Rrethrotullimi i Doganës. Bashkia e Tiranës do të ofrojë bonus qiraje për 3 vjet për të gjitha ato familje që preken nga ky projekt, si dhe do t’i trajtojë me programe të ndryshme sociale. Për të gjithë qytetarët që do të

preken nga ky projekt do të ketë trajtim edhe më të mirë se ai që u trajtuan qytetarët që u shpronësuan nga segmenti i Fabrikës së Miellit deri te TEG-u. Ky projekt do të lehtësojë trafikun në një nga segmentet më problematike të Tiranës.

Fatmirësisht, shumica e qytetarëve që duan shtet dhe zbatimin e ligjit, nuk sulmojnë dhe prishin pronën publike, por janë pro zbatimit të këtij projekti shumë të rëndësishëm. Nëse do të pyesim qytetarët që jetojnë në afërsi të Bulevardit të Ri, dhe jo vetëm, të gjithë do thonë që është bërë një mrekulli për qytetin dhe aty po zhvillohet Tirana. Zbatimi i këtij projekti ka detyruar institucionet përkatëse të bëjnë heqjen e monumentit të shqiptonjës nga Rrethrrrotullimi.

Të gjithë jemi në dijeni dhe po presim që aty të ndërtohet një mbikalim që do të zgjidhë përfundimisht problemin e trafikut në një nga pikat hyrëse të Tiranës, që prej kohësh ka qenë i pazgjidhur, pasi nga njëra anë është fluksi i automjeteve që vijnë nga Jugu dhe Veriu i vendit dhe nga ana tjetër dalja e shumë automjeteve nga Tirana për në qendra të tjera urbane të vendit.

Monumenti i shqiptonjës qëndroi aty si simbolikë për një periudhë të caktuar, por kjo nuk do të thotë se nuk duhet hequr në momentin kur bëhet fjalë për një projekt madhor, sikurse është zgjerimi i unazës së madhe, ndërtimi i mbikalimeve dhe nënkjalimeve, të cilat janë tejet të domosdoshme për të pasur më shumë lirshmëri në trafik.

Ata që duan të bëjnë politikë edhe me heqjen e monumentit shqiptonjës janë në kushtet e një dëshpërimi të thellë dhe vetëvrasjes politike, sepse është e pamundur të bësh politikë me projekte madhore, për të cilat kjo qeverisje ka përgatitur gjithçka deri në detaje. Vetëm nëse nuk duam zhvillim mund të mbetemi në atë që është ndërtuar deri tani. Tirana dhe e gjithë Shqipëria ka nevojë për rrugë, që zhvillojnë ekonominë dhe zgjerimi i Unazës së Madhe është një projekt i tillë.

Disa deputetë të opozitës kanë dalë në mbështetje të protestës së banorëve, të cilët preken nga zbatimi i këtij projekti. Opozita duhet të vijë në parlament, të diskutojë për të gjitha problemet dhe problematikat që e shqetësojnë atë dhe qytetarët, të diskutojë për buxhetin e vitit 2019 në komisionet parlamentare dhe këtu në

seancë plenare dhe jo nëpër banaqe e në konferenca shtypi.

Vendimi i opozitës për të qenë jashtë parlamentit është një ndër vendimet politike më të pakuptimta. Vetëm duke qenë këtu në sallën e parlamentit opozita do të kishte bërë të mundur qoftë edhe nëpërmjet votës, por edhe nëpërmjet diskutimeve, ngritjen e të gjitha pretendimeve të saj. Deputetët e opozitës, pavarësisht numrit të vogël të vendeve në parlament, janë votuar nga qytetarët për të qenë të pranishëm në këtë sallë dhe për të mbrojtur pikërisht nga kjo sallë interesat e votuesve të tyre. Arsyet pse janë jashtë parlamentit, as vetë opozita nuk i ka bërë kurrë të qarta, por sipas mendimit të tyre qeveria duhet të largohet. Në asnjë vend të botës, qoftë edhe në ato me demokraci shumë herë më të brishtë se jona, nuk mund të vihet në pushtet nëpërmjet dhunës, përmes protestave, përmes bojkotit apo përmes rrugëve të tjera. E vetmja rrugë që të sjell në pushtet është vota e qytetarëve shqiptarëve dhe opozita duhet të përballlet me këtë proces për të marrë pushtetin.

Unë kam mendimin se opozita më shumë ka dalë e humbur me votuesit e saj përmes bojkotit sesa e fituar, sikurse ata mendojnë. Sinqerisht, ndiej keqardhje për këtë qëndrim dhe shqetësohem se qëndrimi i opozitës e ka humbur busullën, duke mos ndihmuar në përsheptimin e reformave aq të domosdoshme për integrimin e vendit. Shpresoj se opozita do të kthjellohet dhe do të gjejë forca për të zënë vendin e saj, duke dhënë ndihmesën e shumëmirëpritur në integrimin europian.

Jam e sigurt se në fund të këtij debati do të fitojnë qytetarët, do të fitojnë njerëzit e mirë, njerëzit e drejtë, ata që gjithë jetën e tyre nuk kanë zaptuar, ata që paguajnë rregullisht taksat, ata që duan rendin, ata që respektojnë uniformën, ata që dinë të thonë “Faleminderit” për një punë të mirë dhe për një investim të rëndësishëm për zhvillimin e qytetit.

Në kushtet kur projektligji që ne po diskutojmë sot është në interesin e qytetarëve, është në interesin e qeverisë dhe në përputhje me programin e saj, të nderuara kolege dhe kolegë deputetë, ju ftoj ta miratojmë atë.

Faleminderit!

(Drejtimin e seancës e merr zonja Hysi.)

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Dhima!

Fjalën e ka zoti Balla.

Taulant Balla – Do të doja t'ju thosha shkurtimisht dy fjalë për marrëveshjen e radhës me Republikën Federale të Gjermanisë, vend, i cili në këta 27 vjet mban vendin e parë për sasinë e mbështetjes financiare që i ka dhënë Shqipërisë. Janë mbi 1 miliard euro kredi dhe mbështetje financiare në kuadër të granteve që shteti gjerman i ka dhënë Shqipërisë për projekte nga më të ndryshmet, por ndër to do të doja të vlerësoja mbi 380 milionë euro të dhëna në sektorin e furnizimit me ujë të pijshëm për qytetarët. Besoj se nuk ka një ujësjellës në Shqipëri që nuk ka përfutur apo nuk do të përfutojë, sepse në këtë Kuvend kemi kaluar para pak javësh marrëveshje për disa ujësjellës, nga asistenca e vyer e KfW-së dhe e qeverisë gjermane.

Po ashtu i gjithë rrjeti i transmetimit të energjisë që lidh Shqipërinë me vendet fqinje, qoftë ai me Kosovën, qoftë ai me Malin e Zi, po kështu me Maqedoninë e Greqinë, janë pjesë e investimeve ndër vite të shtetit gjerman për interkonjeksionin energjetik të Shqipërisë me vendet fqinje. Fondi që do të kalojmë sot, i cili bën fjalë për një marrëveshje bashkëpunimi për promovimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes fondit të garancisë të kredive rurale, synon të japë një kontribut të rëndësishëm, pikë së pari, në promovimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme nëpërmjet fondit të garancisë, duke garantuar të gjitha kreditë ndërkombëtare të institucioneve mikrofinanciare, të cilat do t'u ofrojnë kredi kredimarrësve në segmentin e bujqësisë dhe të zhvillimit rural.

Pra, ja edhe një fond tjetër në mbështetje të gjithë atyre vëllezërve dhe motrave shqiptare që jetojnë në zonat rurale të Shqipërisë. Të gjithë e dimë që paketa e buxhetit të këtij viti është tërësisht e fokusuar në një mbështetje si rrallëherë për sektorin e bujqësisë, po të kemi parasysh edhe faktin që për herë të parë një qeveri shqiptare do të zerojë edhe taksën, tatimin mbi vlerën e shtuar të inputeve bujqësore. Është një sipërmarrje e vështirë në aspektin financiar, por është një detyrim që Partia Socialiste dhe qeveria e drejtuar nga Edi Rama ia kishte çdo familjeje që jeton në fshat në Shqipëri.

Duke u rikthyer te marrëveshja me Gjermaninë, besoj se nuk ka asnjë arsye që

deputetët e Partisë Demokratike dhe të Lëvizjes Socialiste për Integrim të mungonin në një marrëveshje si kjo, si edhe në çdo seancë plenare ku ne miratojmë marrëveshje të kësaj rëndësie, sikurse janë marrëveshjet e sotme me Bashkimin Europian, të cilat i shërbejnë Shqipërisë dhe qytetarëve shqiptarë.

Për të mos lënë jashtë vëmendjes betejën e radhës me mullinjtë e erës të asaj çfarë ka mbetur nga opozita në Shqipëri, është e turpshme që pas historive pa fund, pas dështimit të parku i Tiranës dhe të këndi i lojërave në parkun e Tiranës, pas dështimeve të sheshi "Skënderbej", pas historisë të pakuptimit për Teatrin Kombëtar, tani kemi edhe një betejë tjetër idiotke, sikurse është ajo për të penguar vijimin e ndërtimit të Unazës së Tiranës.

Kjo është e pakuptimtë, sepse kryetari në detyrë i opozitës, Lulzim Basha, ka qenë pjesë e përcaktimit të gjurmës se ku kalon Unaza, me firmë dhe me vulë, qoftë si ministër i Transporteve deri në vitin 2007, qoftë edhe si kryetar i Bashkisë së Tiranës në vitet 2011-2015. Gjurma se ku kalon Unaza është miratuar nga Bashkia e Tiranës në vitin 2012. Pra, banorët, që sot ankohen te Lulzim Basha për këtë çështje, duhet të informohen nga vetë Lulzim Basha për gjurmën e përcaktuar.

Unaza do të vijojë. Është jetësore për Tiranën që ky standard i ri zhvillimor, që po vendos qeveria në bashkëpunim me bashkinë, të shkojë deri në fund. Por është e turpshme, që sa herë kemi projekte të rëndësishme zhvillimi, jo vetëm në Tiranë, por edhe në pjesë të tjera të Shqipërisë, Partia Demokratike me Lëvizjen Socialiste për Integrim nga pas synojnë t'i pengojnë ato, të cilat i japin më shumë interkonektivitet kryeqytetit dhe pjesëve të tjera të territorit dhe sigurisht u shërbejnë të gjithë qytetarëve.

Megjithatë, edhe pse sot ata nuk kanë ndonjë takim nëpër hotele, sepse e kanë pushim, siç e kanë marrë pushim prej disa javësh, detyra jonë është t'i miratojmë këto marrëveshje të rëndësishme. Gjithashtu, për të gjithë ata që nuk e dinë, javën e ardhshme në Kuvendin e Shqipërisë do të diskutohet në parim buxheti i shtetit dhe paketa fiskale për vitin 2019.

Apeli im si kryetar i grupit parlamentar të shumicës në Kuvend është që të enjten e ardhshme opozita e ka detyrim të paraqitet në

seancë plenare. Nuk ndodh në asnjë vend të botës së qytetëruar dhe demokratike që opozita të mos marrë pjesë në diskutimin e buxhetit të shtetit. Nuk ka vendim më të rëndësishëm politik për një deputet se të marrë pjesë në diskutimin për buxhetin dhe paketën fiskale. Në pamundësi për të paraqitur një buxhet alternativ ose një paketë fiskale alternative, sikurse duhet ta bënte çdo opozitë në çdo vend evropian, opozita është e detyruar të përfaqësojë atë përqindje të votuesve shqiptarë që i ka dhënë besimin. Deputetët e opozitës të vijnë dhe të sjellin këtu kërkesat e tyre për investime në zonat përkatëse, për rritje të pagave apo për ulje të taksave, sepse kjo është detyra e një deputeti.

Buxheti i vitit 2019 jo vetëm që është buxheti më i madh sa u përket investimeve, por për herë të parë ne sjellim një paketë fiskale, e cila për sektorë të rëndësishëm të zhvillimit të qëndrueshëm të Shqipërisë ul taksat dhe tatimet. Ky është një zhvillim pozitiv. Gjithashtu, sikurse e thashë, jo vetëm imputet bujqësore, por edhe sektorin e turizmit do ta konsolidojmë përmes një mbështetjeje në uljen e taksave dhe të tatimeve.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

A ka ndonjë koleg tjetër që dëshiron të flasë?

Nëse jo, në përfundim të diskutimeve, kalojmë në shprehjen në emër të grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, fjalën e ka deputeti Ervin Bushati.

Ervin Bushati - E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Republika Federale e Gjermanisë ka ndihmuar dhe ka qenë një nga partneret kryesore në rrugëtimin e Shqipërisë drejt Europës, drejt përmirësimit të standardeve të jetesës për të gjithë qytetarët shqiptarë. Sot ajo është kontributori numër 1 në Shqipëri nëpërmjet investimeve direkte që ka bërë në ekonominë shqiptare. Janë 1 miliard euro, të cilat janë investuar nga Republika Federale e Shqipërisë dhe KfW-ja për të përmirësuar jetën e qytetarëve shqiptarë, ekonominë dhe infrastrukturën.

Vlera e këtyre investimeve nuk është vetëm monetare, sepse ajo që sjell Republika Federale e Gjermanisë është një teknologji sot për sot më e

besuara në botë, janë procese pune, janë biznese, mënyrë të menduari dhe të prodhuari nga ekonomia më e besuar në botë. Emri i prodhimeve dhe i teknologjisë gjermane janë në vend të parë sot në botë dhe ne e ndiejmë veten të privilegjuar që bashkë me fondet nga Republika Federale e Gjermanisë, marrim edhe teknologjinë më të mirë në botë.

Bashkë me këtë marrëveshje që miratojmë sot me vlerën 5 milionë euro, fondet që ata kanë dhënë vetëm për zhvillimin ekonomik në mbështetje të bizneseve shkojnë në 176, 6 milionë euro. Nga këto kanë përfituar 2600 ndërmarrje, iniciativa, dhe biznese. Të gjitha këto iniciativa të Republikës Federale, të gjitha këto investime kanë shkuar për të përmirësuar klimën e biznesit, për të lehtësuar procedurat, për të mësuar bizneset si të jenë më efikase në treg, për të lehtësuar marrëdhënien dhe për të përmirësuar klimën e ndërsjellë ndërmjet qeverisjes dhe biznesit. 10 mijë studentë veterinarë janë trajnuar me fondet e dhëna nga Republika Federale e Gjermanisë në të gjitha vitet që pas ndryshimit të sistemit. Pra, sot, ekonomia rurale, bujqësia, bizneset agrare si sektorë kaq të rëndësishëm për Shqipërinë, janë i përmirësuar dhe ecën më mirë, sepse kanë një ndihmesë të fortë nga Republika Federale e Gjermanisë.

Sot ne po miratojmë një marrëveshje, e cila është në sinkron dhe brenda filozofinë sonë për të përmirësuar jetesën në fshat.

Shqipëria 20% të GDP-së e merr nga prodhimet bujqësore, nga ekonomia në fshat, por nuk është ky problemi kryesor, sepse gati gjysma e popullatës jeton në zonat rurale dhe pjesa më kryesore e tyre merret me bujqësi.

Ne të gjithë e dimë se bujqësia shqiptare duhej të ishte avancuar më shumë, duhej të ishte mekanizuar më shumë, duhej të ishte më shumë bashkëpunuese dhe konsoliduese, por këto procese kanë nisur nga zeroja në vitin 1990. Ndihej se na ka dhënë qeveria gjermane është më se e vlerësuar dhe është në sinkron me një sërë ndryshimesh, që ne kemi ndërmarrë për të ndihmuar ekonominë rurale.

Në radhë të parë, jemi përpjekur që ekonomia e shkallës të fillojë të funksionojë. Pra, që procesi i bashkimit të forcave të kapitalit të dalë në mënyrë më efikase në treg, për të ulur çmimet, për të rritur produktivitetin, për të ulur

kostot, për të rritur cilësinë dhe standardizimin e produkteve bujqësore, është ndihmuar, duke paraqitur në paketën fiskale ulje minimale tatimfitimi deri në 5%, për të gjitha kompanitë që fillojnë të bashkëpunojnë në sistemin agrar. Gjithashtu, kemi ulur në 6% TVSH-në për çdo biznes agrar, që kombinohet me turizmin në mënyrë që të ketë një shtysë tjetër.

Në Shqipëri po zhvillohet sektori i turizmit, i cili po fillon të kthehet në një sektor prioritar jo vetëm për të ardhurat që sjell në vetvete nga njerëzit që vijnë dhe vizitojnë Shqipërinë, por edhe si një sektor promovues, si një gjenerator që shton punësimin, kapitalin, produktet dhe shërbimet, kryesisht produktet e zonave rurale, të cilat duhet të shkojnë në funksion të turizmit. Për të lehtësuar këtë tranzicion dhe për ta bërë atë edhe më produktiv, njëra nga masat që ne morëm dhe miratuam në këtë parlament, dhe që shkon në këtë filozofi, ishte ulja e TVSH-së.

Ne ftojmë të gjitha bizneset agrare, të gjitha kompanitë, të gjithë bujqit, të cilët e sigurojnë jetesën tyre me këto produkte, të fillojnë t'i aplikojnë në biznesplanet dhe iniciativat e tyre këta stimuj që ne po u japim nëpërmjet uljes së tatimfitimit dhe uljes së TVSH-së. Ka ardhur momenti që këto instrumente fiskale, që qeveria me të drejtë i ka zbatuar dhe i ka sjellë më pranë bujkut, të mendohen si të tilla, si dhe të promovohen edhe më shumë nga Ministria e Bujqësisë.

Në të ardhmen sektori i zhvillimit rural dhe sektori i prodhimit bujqësor duhet të jenë më shumë inovativë, duhet të jenë më shumë në sinkron me kohën, duhet të jenë më shumë të përafruar edhe me legjislacionin e BE-së, sepse që të mund të përthithen fonde nga bizneset shqiptare ka kushte dhe kritere, të vendosura nga BE-ja, të cilat duhen zbatuar.

Janë shumë fonde që do të vihen në dispozicion vitin që vjen, por edhe në vitet në vijim për bujqit shqiptarë, për bizneset agrare, për bizneset e agroturizmit, të cilat, patjetër, duhet të harmonizohen jo vetëm me legjislacionin, por edhe me mënyrën e të menduarit dhe të funksionuarit njëloj si në Europë.

Gjithashtu, dua të përfitoj nga rasti të falënderoj Republikën Federale të Gjermanisë, e cila ka ndihmuar 2 mijë e 600 ndërmarrje dhe biznese; ka trajnuar mbi 10 mijë studentë në

veterinari; ka ndihmuar mbi 7400 biznese agrare dhe bujqësore në Shqipëri; ka ndihmuar në piketimin dhe hapjen e 42 rrugëve malore për turizmin, në ndihmë të ekonomisë rurale; ka shtuar 85 kilometra rrugë rurale dhe të gjitha këto i ka bërë me paratë e taksapaguesve gjermanë. Pra, qytetarët gjermanë, duke paguar taksat, kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë nëpërmjet granteve. Të gjithë ata që nuk e kuptojnë fjalën “grant”, në shqip do të thotë para të falura nga Republika Federale e Gjermanisë.

Prandaj, mirënjohja jonë si parlament, si maxhorancë, si qeveri, si klasë politike duhet t'i shkojë qeverisë gjermane. Kjo mirënjohje duhet të ishte edhe në leksikon dhe argumentin e opozitës, sepse është jo vetëm një partner strategjik, i cili po na ndihmon në politika dhe në integrim, por është edhe partneri numër një në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë, me 1 miliard euro të investuara në gjithë këta vjet.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Bushati!

Fjalën ka kërkuar, zoti Peleshi.

Neni 47 i Rregullores, që bën fjalë për të drejtën e fjalës për anëtarët e Këshillit të Ministrave, në paragrafin e dytë, thotë: “Kur anëtarët e Këshillit të Ministrave kërkojnë të flasin pas mbylljes së diskutimeve, rihapet diskutimi i çështjes që është në shqyrtim”.

Fjala për zotin Peleshi. Nëse ndonjë nga kolegët dëshiron të flasë më pas, është i mirëpritur.

Niko Peleshi – Shumë faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Në fakt, nuk do të zgjatem, sepse dhe kolegu parafolës e shtjelloi shumë mirë kontekstin dhe rëndësinë e këtij fondi, e këtij projekti të ri, në mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme bujqësore nëpërmjet bankës gjermane KfW.

Unë dua t'i bashkohem mirënjohjes për qeverinë gjermane për projektet e bankës gjermane KfW, por edhe të agjencisë GIZ në mbështetje të Shqipërisë, veçanërisht të bujqësisë shqiptare në vite. Dua t'ju kujtoj se GIZ është sot koordinatori i ndihmës së huaj, pra i të gjithë koordinatorëve dhe partnerëve tanë, në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural në përgjithësi.

Ky projekt vjen si vazhdim i një projekti të kaluar në vlerën 3,5 milionë euro, nëpërmjet të

cilit, me shumë sukses, u mbështetën mbi 1 mijë kredi të vogla me rreth 1500 fermerë shqiptarë të punësuar.

Bazuar në suksesin e projektit të mëparshëm, ne do të miratojmë sot, me mbështetjen e këtij parlamenti, projektin e ri me vlerën 5 milionë euro. Ky projekt garanton kredi tregtare të institucioneve pjesëmarrëse, ku ka disa portofola, për të cilët nuk do të zgjatëm, sepse janë të gjitha në relacion. Kjo mbështetje fillon nga 30% deri në 100% të garantimit të kredisë, ku bëhet fjalë për kredi nga institucionet e mikrofinancës, konkretisht NOA dhe FEDinvest.

Ky projekt është i rëndësishëm, mbi të gjitha, viti 2019 do të shënojë mbështetjen më të madhe historike për bujqësinë, përmes programit të mbështetjes IPARD nga Bashkimi Europian dhe qeveria shqiptare, që së bashku me dy kontributet, kap vlerën 94 milionë euro, duke shtuar këtu edhe skemën kombëtare të mbështetjes financiare, e cila edhe këtë vit do të jetë në vlerën 20 milionë euro, pra po ta krahasojmë me vitin 2017, është pothuajse dy herë më e lartë. Edhe këtë vit vazhdon i njëjti trend rritjeje.

Në total kemi më shumë se 100 milionë euro financime, siç e tha edhe zoti Bushati, me para falas, pra me grante. Natyrisht, mbështetja me grante nuk shkon në 100% të masës së investimit, por duhet që fermerët apo investitorët në bujqësi dhe agropërpunim të kenë kapitalet e tyre, 30, 40 deri në 50%, që jo gjithmonë janë të mundura. Pra, çdo investitori apo fermeri do t'i duhet t'i garantojë këto kapitale nga kursimet ose nga kreditimi i institucioneve financiare. Vlerën totale të investimit, natyrisht, fermeri duhet ta ketë paraprakisht, sepse granti, qoftë nga IPARD-i, qoftë nga skema kombëtare e mbështetjes financiare, jepet në fund, pas realizimit të investimit.

Duhet t'ju them se financimi përmes kreditimit është i domosdoshëm edhe për përfutjesit e skemave tona kombëtare, që, siç e thamë, janë grante.

Mundësitë janë të shumta edhe për këtë pjesë. Kjo është një mundësi e shtuar, sidomos për fermerët e vegjël.

Fondi për garantimin e kredive rurale përmes KfW-së, i shtohet fondit tonë të garancisë, të BERZH-it dhe qeverisë shqiptare,

përmes të cilit janë mbështetur rreth 3000 kredi. Jemi në negociata për ta bërë më fleksibël dhe më atraktiv këtë fond, këtë mbështetje, këtë garantim të kredive, me institucionet që marrin pjesë, që janë kryesisht bankat tregtare, por edhe disa institucione të mikrofinancës.

Siç e tha edhe zoti Balla, po punojmë me shumë intensitet me Ministrinë e Financave, natyrisht, edhe me vullnetin e Kryeministrit, që të shkojmë drejt zerimit të TVSH-së së imputeve bujqësore, duke filluar nga 1 janari i vitit 2019. Kjo i shtohet mbështetjes financiare historike që bujqësia shqiptare do të ketë nga viti 2019 e në vazhdim. Duhet ta them që kjo është masa e parë që shkon drejtpërdrejt si një mbështetje financiare për çdo fermer në Republikën e Shqipërisë.

Në qoftë se përmes subvencioneve mbështeten 3000 apo 4000 fermerë në vit, në qoftë se përmes rimbursimit të TVSH-së, përmes autofaturimit nga grumbulluesit, këtë vit përfitojnë rreth 11 mijë apo 12 mijë fermerë, me këtë masë mbështetjeje, pra me përjashtimin nga TVSH-ja të të gjitha imputeve bujqësore, përfitojnë mbi 300 mijë fermerë në të gjithë Shqipërinë, nga 1 fermer i vogël që ka një bahçe të vogël, deri te fermerët e mëdhenj. Të gjithë fermerët përdorin impute bujqësore: fara, fidanë, plehra, pesticide. Me shumë gjasa, përmes një pune shumë intensive, duke filluar nga 1 janari i vitit 2019 do ta çojmë mundësisht drejt zeros TVSH-në e këtyre imputeve bujqësore, çka do të thotë se automatikisht do të ulim me pothuajse 20% koston e prodhimeve bujqësore.

Ju kujtoj se imputet bujqësore zënë rreth 50% të koston së një produkti bujqësor, nga 40-55%. Kjo nuk është një masë e vogël, sepse ul në mënyrë drastike koston e prodhimit bujqësor shqiptar, që do të thotë se e bën atë më konkurrues dhe rrit konkurrueshmërinë e prodhimeve tona bujqësore.

Kjo është rruga në të cilën po ecim. Nga njëra anë duam të rrisim konkurrueshmërinë, të forcojmë dhe të shtojmë bujqësinë komerciale në vend, bujqësinë që eksporton gjithnjë e më tepër (2 vitet e fundit, me dy shifra), pra rriten eksportet e bujqësisë shqiptare, dhe, nga ana tjetër, nuk harrojmë se në strukturën e ekonomisë bujqësore shqiptare, më shumë se 80% janë fermerë të vegjël, fermerë që fatkeqësisht nuk arrijnë akoma standardin e kërkesës së eksportit,

ama plotësojnë një kërkesë shumë të madhe vendase. Pjesa më e madhe e kërkesës vendase plotësohet nga fermerët e vegjël, që janë shumë të rëndësishëm, për të cilët jemi duke bërë gjestin e parë të drejtpërdrejtë, mbështetjen e parë të drejtpërdrejtë financiare, përmes uljes së TVSH-së.

Do të bëhemi vendi më konkurrues në rajon, në qoftë se do t'ia dalim ta çojmë mundësisht në zero TVSH-në e imputeve bujqësore, nismë kjo e Kryeministrit Rama, të cilën mezi po e presin, se pari, fermerët dhe të gjithë ata që punojnë në sektorin tonë.

Shumë faleminderit!

Mirënjohës edhe për Ministrinë e Financave, që po tregohet shumë bujare!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Peleshi!

Këtu mbyllet diskutimi për projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2017, për projektin “Promovimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, përmes fondit të garancisë së kredive rurale””.

Kalojmë te çështja tjetër e rendit të ditës, te projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes me vendin pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor”.

Për këtë projektligj janë regjistruar: zonja Mimi Kodheli, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, zoti Andrea Marto, si dhe ka kërkuar fjalën ministri Bushati.

Zoti Ministër, do të prezantoni nismat, apo do të diskutoni?

Dakord.

Zonja Kodheli keni fjalën.

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Në korrik të dy vjetëve më parë në Paris, midis përfaqësuesve të Ballkanit Perëndimor u nënshkrua një marrëveshje, që do t'i hape rrugë krijimit të Zyrës Rajonale të Bashkëpunimit Rinor. Kjo do të jetë zyra e dytë e përfaqësimit në nivel rajonal që do të ketë vendi ynë.

Në marrëveshje thuhet se kjo zyrë do të mbështesë aktivitete që inkurajojnë pajtimin, mirëkuptimin reciprok, shkëmbimin e përvojave, vlerat demokratike, pjesëmarrjen, qytetarinë aktive dhe të mësuarin ndërkulturore ndërmjet të rinjve, por edhe forcimin e stabilitetit, zhvillimin

e qëndrueshëm dhe progresin në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

E parë përceptas duket sikur kjo zyrë do të jetë një midis shumë organizmave që, në përpjekjen për të ndryshuar të ardhmen, dështojnë suksesshëm. Unë besoj fort që jo.

Do të mundohem të ndaj me ju, kolegë, disa prej arsyeve pse e mendoj hapjen e kësaj zyre një funksion ndryshe. Gjithsecili prej nesh i ka vetëm një borxh gjeneratës tjetër, kjo është e ardhmja. “Paqtimi dhe mirëkuptimi reciprok”, thuhet në arsyet e krijimit të qendrës. Ballkani Perëndimor ka bërë hapa vigane në këtë drejtim. Shumë vende të këtij rajoni kanë qenë në konflikt të hapur dy dekada më parë. Sot flasim për një rrugë të përbashkët europiane, por që këto dy gjëra të funksionojnë mirë me fqinjët, duhet së pari të bëjmë të funksionojmë mes vedit, e atëherë shumë të dimë si t'ua transmetojmë këtë të rinjve. Sa të zotë kemi qenë ta bëjmë këtë deri sot? Nuk e di. Por pyetjen nuk e kam retorike.

Shkëmbimi i përvojave

Shpresoj që kjo qendër të gumëzhijë nga projektet që lidhen pikërisht me këtë gjë. Në këtë pikë të rinjtë nuk kanë nevojë për politikëbërës të sotëm, pra politikanët së shumti mendojnë se përvoja jonë politike dhe atë me shumë ajo personale është më unikalja dhe më e mira. Mund të kesh përvojë, por kur nuk ke nxjerrë mësim, ajo që vlen për të treguar është vetëm një telenovelë.

Vlerat demokratike

Është abuzuar shumë me to dhe në emër të tyre. Inflacioni i lartë e zhvlerëson çfarëdolloj vlere, ashtu si në fakt edhe ka ndodhur me vendet e rajonit tonë, ku është folur shumë për këto vlera dhe pak është mbërritur. Qendrës i del për detyrë të punojë me të rinjtë që këto vlera të mund t'i përvetësojnë çdo ditë, me qëllim që brezat më pas të mos rrëshkasin në demagogji boshe dhe patetizëm. Të dyja këto të fundit e kanë lënë politikën e vendeve tona akoma të rreshtuar nga fundi. Shpresoj që e ardhmja prosperoze të mos jetë ajo që troket e fundit të ne.

Pjesëmarrje dhe qytetari aktive

Teknologjia, më shumë sesa politika jonë, ka ndihmuar që ky fenomen të rritet në mënyrë eksponenciale. Por a është të sharët pas një emri fals në rrjetet sociale baras me pjesëmarrjen dhe

qytetarinë aktive? Unë mendoj se jo. A është të gjuajturit me baltë më shumë se propozimet konstruktive pjesëmarrje qytetarie aktive? Unë mendoj se jo.

A mund t'u transmetojmë ne të rinjve një qasje tjetër lidhur me qytetarinë aktive? Sigurisht, mendoj se jo, pasi ne, të rriturit, po ju lëmë të rinjve një vend ku mbizotëron nihilizmi, arroganca, indiferenca dhe qasja e gabuar ndaj çështjeve dhe parimeve themelore, që kanë të bëjnë drejtpërdrejt apo tërthorazi me të ardhmen e tyre. Prandaj na duhet të reflektojmë sot.

Zhvillim i qëndrueshëm, stabilitet dhe progres

Këto janë tri fjalë të rëndësishme për rajonin, madje shumë të rëndësishme. Nëse ka stabilitet dhe qëndrueshmëri në atë që bashkërisht do të bëjmë si rajon, pa dyshim që do të ketë edhe progres. Por sado që të rinjtë punojnë për këtë detyrë imperative, kjo i mbetet vetëm politikës, iu mbetet qeverive të vendeve respektive dhe nivelit të bashkëpunimit mes tyre. I mirëprituri Proces i Berlinit apo të tjerë të ngjashëm me të, janë procese dhe struktura që ndihmojnë, por nuk mund ta zëvendësojnë kurrë mundin, vizionin, transparencën dhe punën që duhet të burojë nga brenda politikëbërjes në vendet tona në këtë rrugë të përbashkët integrimi vlerash perëndimore. Ndaj objektivi për thellimin e bashkëpunimit rajonal, si një nga prioritetet kyçe të politikës sonë të jashtme, mendoj se është një prej objektivave më kuptimplotë.

Meqë me jepet rasti, dua të komplimentoj Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme që mundësoi sjelljen e kësaj zyre në Tiranë.

Ftoj kolegët ta miratojnë këtë projekt, që shpresoj se do të jetë një mekanizëm më shumë jo vetëm në rritjen e bashkëpunimit rajonal, por një ndihmesë për të kuptuar rëndësinë e të qenit bashkë për një të ardhme më të mirë, pikërisht atë borxhin që në llogaritë tona e kemi ende të pashlyer.

Ju faleminderit!

Vasilika Hysi - Faleminderit, zonja Kodheli!

Fjalën e ka zoti Bushati.

Ditmir Bushati - Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne sot po shqyrtojmë marrëveshjen për vendin pritës ndërmjet Shqipërisë dhe Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor. Kjo është një nga dy iniciativat, me seli në Tiranë, së bashku me fondin për Ballkanin Perëndimor. Kjo është një iniciativë e rëndësishme, pjesë e Procesit të Berlinit, e iniciuar për një bashkëpunim më të ngushtë mes vendeve të Ballkanit Perëndimor, me fokus të posaçëm çështjet e ripajtimt.

Dy milionë euro është fondi vjetor që japin të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, por kryesisht Gjermani dhe Franca, duke qenë se kjo nismë pasqyron, deri diku, nismën franko-gjermane të pas Luftës së Dytë Botërore, ku kontinenti kishte nevojë për paqim dhe për besim të ndërsjellë. Franca dhe Gjermania këtë praktikë e sjellin edhe në rastin e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Kjo nismë drejtohet nga një koleg serb, ndërkohë që numri 2 apo nëndrejtori i nismës është një koleg nga Kosova, me seli në Shqipëri. Pra, edhe vetë simbolika e selisë në Tiranë, deri diku me një bashkëdrejtim të një kolegu nga Serbia dhe nga Kosova, është mesazh i qartë për procesin e pajtimt, në të cilin duhet të përfshihet rajoni ynë, me fokus të posaçëm tek të rinjtë.

Element tjetër i rëndësishëm për këtë nismë janë projektet, të cilat po zbatohen aktualisht. Janë rreth 38 projekte, të cilat rrokin një numër të caktuar organizatash rinore, sikundër vetë kjo nismë ka arritur të ketë një bashkëpunim më të strukturuar me OKB-në, duke i dhënë një fokus, gjithashtu, të qartë rolit të të rinjve në të ashtuquajturat konflikte të ndryshme.

Ne synojmë të lehtësojmë më tej praninë e nismave të tilla rajonale në Shqipëri, në Tiranë, si pjesë të ushtrimit më aktiv të politikës sonë të jashtme. Meqenëse kjo seancë mbahet një ditë pas mbledhjes së djeshme, takimit të dhjetë të Këshillit të Stabilizim – Asociimit, Shqipëri-BE, më vjen mirë që edhe në këtë mbledhje u konfirmua pozicioni i qartë, kontributi aktiv dhe dinamik i Shqipërisë në rajon, linjëzimi njëqind për qind i politikës sonë të jashtme me atë të Bashkimit Europian, kontributi për paqe, stabilitet demokratik dhe prosperitet i Shqipërisë i që në asnjë moment nuk është vënë në pikëpyetje.

Gjithashtu, Këshilli i Stabilizim – Asociimit, Shqipëri – BE, konfirmoi stadin e reformave në fushën e sundimit të së drejtës,

kryesisht reformës në drejtësi, luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, duke qenë se vetë vendet anëtare të Bashkimit Europian, në qershorin e këtij viti përcaktuan një kalendar të qartë në lidhje me fillimin e bisedimeve për anëtarësim. Po ashtu, dhanë dritën jeshile për fillimin e punës përgatitore, apo siç quhet ndryshe, në gjuhën teknike, procesi *screening*, proces i cili ka filluar, proces molekular ndërmjet Komisionit Europian, nga njëra anë, dhe administratës publike shqiptare.

Gjej rastin për t'i bërë edhe një herë tjetër thirrje opozitës parlamentare që të ushtrojë përgjegjësitë e saj në këtë proces të rëndësishëm, që nuk ka të bëjë me fatet e partive politike, të cilat vijnë e ikin, por ka të bëjë me Shqipërinë dhe shqiptarët. Kryesisht e kam fjalën për kalendarin e përbashkët për miratimin dhe zbatimin e reformës zgjedhore, si dhe kalendarin e përbashkët për miratimin dhe zbatimin e elementëve që kanë të bëjnë me reformën në drejtësi.

Është i pakuptueshëm për çdo qytetar të zakonshëm të këtij vendi, siç është po ashtu i pakuptueshëm për çdo partner europian, që e mbështet Shqipërinë në procesin e anëtarësimit në BE, refuzimi i opozitës parlamentare për t'i dhënë mundësinë Shkollës së Magjistraturës që ta furnizojë me shumë sistemin e ardhshëm të drejtësisë me burime më serioze në këtë drejtim, me burime të cilat nuk preken apo nuk mund të preken nga virusi që ka prekur sistemin tonë të drejtësisë.

Gjithashtu, është i pakuptueshëm për çdo qytetar të zakonshëm të këtij vendi, por edhe për çdo partner europian që na mbështet në këtë proces, refuzimi, balta e opozitës ndaj procesit të vetingut, i cili në fund të ditës është një proces pastrimi radikal i pallatit të drejtësisë, që rikthen te njerëzit besimin në institucionet e shtetit të së drejtës.

Prandaj, edhe këto nisma, që sado të vogla, domethënëse për rolin dhe peshën tonë gjithnjë e në rritje në rajon, në ushtrimin e përgjegjësiave, që kanë lidhje me politikën e jashtme, duhet të shihen gjithnjë të lidhura me përparimin që bën vendi ynë drejt anëtarësimit në Bashkimin Europian.

Në përfundim, dua të falënderoj të gjithë kolegët deputetë të komisionit parlamentar, që kanë shqyrtuar këtë marrëveshje, për

mbështetjen e pakursyer që kanë dhënë gjatë këtij procesi!

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Bushati!

Këtu mbyllet lista e diskutantëve.

Kalojmë në diskutimet në emër të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, fjalën e ka deputeti Andrea Marto.

Andrea Marto – Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes me vendin pritës ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor” synon të realizojë marrëveshjen e datës 4 korrik 2016 ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor për ngritjen e Zyrës Rajonale për Bashkëpunimin Rinor.

Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje bëhet i mundur krijimi i kësaj zyre, me seli në Tiranë, duke treguar kështu qartazi vullnetin politik dhe vizionin e ri që ka Shqipëria për rajonin e më gjerë.

Marrëveshja vjen e ndarë në dy pjesë: preambula dhe 24 nene, në të cilat parashikohen si më poshtë: privilegjet dhe imunitetet që do të gëzojë Zyra Rajonale për Bashkëpunim Rinor; përjashtimin nga taksat në të njëjtat kushte siç është parashikuar për misionet diplomatike të akredituara në Republikën e Shqipërisë. Në lidhje me personalitetin e saj juridik, Zyra Rajonale për Bashkëpunim Rinor është themeluar si një organizatë ndërkombëtare, e për këtë do të gëzojë personalitetin juridik, që parashikon ligji në rastet e organizatave ndërkombëtare. Siguria e godinës dhe pajisjet janë në pronësi të Zyrës Rajonale të Bashkëpunimit Rinor, si dhe forma e hyrjes në fuqi të marrëveshjes. Institucioni i ngarkuar për zbatimin e saj është Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme.

Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje synon të mbështesë shkëmbimet rajonale ndërmjet të rinjve, ndarjen e ideve mes tyre, bazuar në vlerat e tolerancës dhe të respektit për të drejtat e njeriut, angazhimin për gjithëpërfshirje, që është një bazë e gjerë për bashkëpunimin në të ardhmen, duke përfshirë vlerat e diversitetit me fokus parimet e qeverisjes demokratike, zhvillimin e arsimit, inovacionin etj.

Angazhimi i Republikës së Shqipërisë në një nismë të tillë bëhet edhe në kuadër të MSA-

së. Mendoj se hyrja në fuqi e kësaj marrëveshjeje realizon objektivat e politikës së jashtme të Republikës së Shqipërisë, veçanërisht objektivin për thellimin e bashkëpunimit rajonal, si një përparësi për politikën tonë të jashtme.

Vlerësoj se ratifikimi i kësaj marrëveshjeje thekson përpjekjet serioze dhe të vazhdueshme të Republikës së Shqipërisë për të nxitur bashkëpunimin rajonal për marrëdhënie të mira fqinjësore.

Ju faleminderit, të nderuar kolegë! Ju ftoj ta votoni këtë marrëveshje të rëndësishme!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Marto!

Këtu mbyllet diskutimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes me vendin pritës ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor”.

Ju lutem, kolegë, për dy minuta do të fillojmë votimin.

(Rifillon seanca)

Vasilika Hysi – Kolegë, zini vendet.

Hapet votimin për prezencën.

Mbyllet votimi.

Të pranishëm janë **76** deputetë.

Kalojmë në votimin e projektligjit “Për një ndryshim në ligjin nr. 9426, datë 6.10.2005 “Për mbarështimin e blegtorisë”, të ndryshuar”.

Hapet votimi me elektronikë në parim.

Mbyllet votimi.

73 vota pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Vazhdojmë me votimin nen për nen me kartonë, sipas variantit të propozuar, meqë komisioni përgjegjës nuk ka bërë vërejtje.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

74 vota pro. Abstenim? Nuk ka. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar”.

Hapet votimi me elektronikë në parim.

Mbyllet votimi.

74 vota pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Vazhdojmë me votimin nen për nen me kartonë, sipas variantit integral të paraqitur nga komisioni përgjegjës, në të cilin janë reflektuar edhe propozimet e Komisionit të Sigurisë Kombëtare, si komision për dhënie mendimi.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 3. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 4. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 5. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 6. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 7. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 8. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 9. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 10. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 11. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 12. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 13. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 14. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 15. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 16. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 17. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 18. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.

Neni 19. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.

Neni 20. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.

Neni 21. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.

Neni 22. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.

Neni 23. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.

Neni 24. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.
Hapet votimi me elektronikë për projektligjin në tërësi.
Mbyllet votimi.
74 vota pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim?
Nuk ka.
Miratohet projektligji.

Kalojmë në projektligjin “Për disa shtesa në ligjin nr. 9584, datë 17.07.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar”.

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe nenit 55 të Rregullores, ky projektligj kërkon një shumicë të thjeshtë votash për miratim.
Hapet votimi në parim me elektronikë.
Mbyllet votimi.
73 vota pro. 1 votë kundër. Abstenim? Nuk ka.
Miratohet në parim projektligji.

Vazhdojmë me votimin nen për nen me kartonë, duke pasur parasysh vërejtjet e propozuara nga komisioni përgjegjës.
(Ndërhyrje pa mikrofon)
Nuk kam kërkesë për shpjegim vote.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.

Neni 2, me vërejtjet e komisionit përgjegjës nga ana e teknikës legjislativë.
Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.

Neni 3. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.

Neni 4. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi.
Mbyllet votimi.
73 vota pro. 1 votë kundër. Abstenim? Nuk ka.
Miratohet projektligji.

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Unë dua të shpjegoj votën time kundër, jo pse jam kundër tabelës së pagave, por nuk mund ta barazoj dot pagën e drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT-it me pagën e një ministri. Ne zakonisht veprojmë kështu dhe bëjmë gabim, por duhet ta shikojmë në tërësi sistemin e pagave në Republikën e Shqipërisë. Realisht ju keni miratuar që paga e drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT-it do të bëjë pjesë në tabelën D 06. Çfarë është 06-ta, që ta dinë edhe deputetët?

Paga e Presidentit është 2 milionë e 570 mijë lekë të vjetër herë 0,6 i bie afërsisht 1 milion e 540 mijë lekë, që do të jetë rroga e drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT-it, aq sa është edhe rroga e një ministri.
Faleminderit!

Vasilika Hysi – Kalojmë në votimin e projektligjit “Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit, që ndryshon memorandumin e mirëkuptimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e drejtësisë së Bashkimit Europian”.

Në mbështetje të neneve 121 dhe 122 të Kushtetutës, ky projektligj kërkon shumicë absolute për miratim.
Hapet votimi me elektronikë në parim.
Mbyllet votimi.
74 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.
Miratohet në parim.

Kalojmë në votimin nen për nen me kartonë, sipas variantit të paraqitur nga propozuesi.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.
Hapet votimi me elektronikë.
Mbyllet votimi.
74 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.
Miratohet në tërësi projektligji

Kalojmë te projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP)”.

Në mbështetje të neneve 121 dhe 122 të Kushtetutës, ky projektligj kërkon për miratim shumicë absolute.

Hapet votimi me elektronikë në parim.

Mbyllet votimi.

74 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen me kartonë, sipas variantit të paraqitur nga propozuesi.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

74 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim, 3 deputetë nuk kanë votuar.

Miratohet në tërësi projektligji.

Kalojmë te projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2017, për projektin “Promovimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes fondit të garancisë së kredive rurale”.

Në mbështetje të neneve 121 dhe 122 të Kushtetutës, ky projektligj kërkon për miratim shumicë absolute.

Hapet votimi me elektronikë në parim.

Mbyllet votimi.

74 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim, 2 deputetë nuk votuan.

Miratohet në parim projektligji.

Kalojmë në votimin nen për nen me kartonë, sipas variantit të paraqitur nga propozuesi.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. “Hyrja në fuqi”. Komisioni propozon hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon.)

Atëherë, në mbështetje të nenit 84/4 të Kushtetutës thuhet: “Në rastet e masave të jashtëzakonshme, si dhe në rast nevojë e urgjence, kur Kuvendi vendos me shumicën e të gjithë anëtarëve dhe Presidenti i Republikës jep pëlqimin, ligji hyn menjëherë në fuqi vetëm pasi të jetë njoftuar publikisht. Ligji duhet të botohet në numrin më të parë të Fletores Zyrtare”.

Lidhur me këtë ju njoftoj se Presidenti i Republikës, me shkresën nr. 3197/2, datë 14.11.2018, ka dhënë pëlqimin. Kuvendi vendos me shumicë absolute votash.

Hapet votimi me elektronikë për hyrjen menjëherë në fuqi të ligjit.

Mbyllet votimi.

74 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim, 2 deputetë nuk kanë votuar.

Ligji hyn në fuqi menjëherë.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

74 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim, 2 deputetë nuk kanë votuar.

Miratohet në tërësi projektligji.

Kalojmë në votimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes me vendin pritës ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor”.

Në mbështetje të neneve 121 dhe 122 të Kushtetutës, ky projektligj kërkon shumicë absolute për miratim.

Hapet votimi me elektronikë në parim.

Mbyllet votimi.

74 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim, 2 deputetë nuk kanë votuar.

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen me kartonë, sipas variantit të paraqitur nga propozuesi.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

74 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim, 2 deputetë nuk kanë votuar.

Ligji hyn

Miratohet në tërësi projektligji.

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË ENJTE, 15 NËNTOR 2018

Nga seanca e kaluar është mbartur për votim projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.”

Sikurse jeni në dijeni, mungesa e opozitës nuk e mundëson votimin e këtij projektligji.

Gjithashtu është mbartur për votim nga seanca e kaluar edhe projektligji “Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Në mbështetje të nenit 81/2 të Kushtetutës, ky projektligj kërkon një shumicë të cilësuar prej 3/5-ve të të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Duke qenë se opozita nuk është e pranishme, edhe ky projektligj nuk mund të votohet.

Këtu mbyllet seanca e ditës së sotme.

Seanca tjetër do të njoftohet nëpërmjet medieve.

Faleminderit për vëmendjen!

(Seanca u mbyll në orën 12:30)

Kryetari i Kuvendit

Gramoz Ruçi

Sekretari për Procedurat dhe Votimin

Alket Hyseni

**Drejtori i Shërbimit të Botimeve
Parlamentare
Krenar Hajdëri**